



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3108 Prot.

Roskovec, më 26, 04, 2024

VENDIM

NR 30 . DATË 26 . 04 .2024

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKIMIT TË PLANIT TË
PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË ROSKOVEC ME PROCEDURË TË
THJESHTUAR”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; neni 23 pika 14, neni 54 shkronja k), të Ligjit 107/2014, datë 31.04.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, I ndryshuar, neni 12, neni 26, të VKM Nr.686, datë 22.11.2017, “Për Miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, neni 11, neni 12 dhe Udhëzuesin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Nr.01, datë 22.02.2019 “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur këtij vendimi:

- Dokumenti i rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Roskovec
- Relacion shpjegues për miratimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec
- Nismën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Roskovec.

KRYETAR
Afrim Plaka

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSKRYETAR

Ermira Buzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 8314 prot

Data: 29.11.2023

VENDIM

Nr. 153, Datë 29.11.2023

**“PËR
NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA ROSKOVEC ME
PROCEDURË TË THJESHTUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

VENDOSI:


1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgimie historike e kulturore;
 - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojne dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të

menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Roskovec.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI

Znj. Majlinda Buri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 8315 Prot.

Roskovec, më 29.12.2023

URDHËR

Nr 253, datë 29.12.2023


**PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTAVE TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA ROSKOVEC ME PROCEDURË TË
THJESHUAR**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 23 pika 14, rë ligjit 107/2014, datë 1.10.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 13 pika 1/c; dhe VKM nr 686, date 22.11.2017,"Per miratimin e rregullores se planifikimit te territorit", nenet 11 dhe 12, si edhe Kreu 2, seksioni 7, neni 51,

Urdhëroj

- 1- Krijimin e grupit të punës për rishikimin e dokumentave të Planit të Përgjithshëm Vendor, bashkia Roskovec me procedurë të thjeshtuar.
- 2- Grupi i punës do të ketë përbërje si më poshtë:
 1. Eneida Hoxha- Drejtor i planifikimit dhe zhvillimit të territorit
 2. Arjela Kushi - Ekspert planifikimi
 3. Vjollca Zeqo- Drejtor Juridik dhe Burime Njerëzore
 4. Eva Hatia- Përgjegjëse e sektorit të planifikimit dhe lejeve të ndërtimit
 5. Gazment Zeneli- Ekspert Mjedisi
 6. Eldison Kocaqi – Përgjegjës i sektorit të regjistrimit të pronave
 7. Genci Myftari – Përgjegjës i sektorit të bujqësisë
- 3- Grupi i punës do të jetë përgjegjës për rishikimin dhe hartimin e draft dokumentave të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin administrativ të Bashkisë Roskovec e cila do të bëhet me procedurë të thjeshtuar.

- 4- Ngarkohet grupi i punës si më sipër të ndjekë të gjithë procedurën sipas hapave ligjore për për hartimin dhe rishikimin e dokumentave të Planit të Përgjithshëm Vendor deri në miratimin e tij nga KKT.
- 5- Ngarkohet Sektori i Sekretari-Arkivit të kryejë njoftimet përkatëse.
- 6- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në RKPT.






REPubLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

NISMA

PËR RISHIKIMIN E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA ROSKOVEC



19.01.2024

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
BAZA LIGJORE	4
1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT	5
2. DOKUMENTET, PJSË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT	6
3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË	6
4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE..	7
5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT.....	8
6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË	8



A large, stylized handwritten signature in black ink, located at the bottom left of the page. The signature is composed of several overlapping loops and lines.

HYRJE

Bashkia Roskovec ndodhet në jug-perëndim të Shqipërisë. Bashkia e Roskovecit është pjesë integrale e territorit të Qarkut Fier, një nga 12 qarqet e vendit, që ndodhet në pjesën jugperëndimore të vendit në një terren kodrinor të ulët dhe fushor (pjesë e fushës së Myzeqesë) dhe kufizohet me bashkitë: Fier, Lushnje, Ura Vajgurore, Mallakastër, e Patos.

Karakteristikat gjeografike/territoriale

Roskoveci ndodhet në pjesën juglindore të fushës së Myzeqesë, pikërisht në kufi me kodrat e Mallakastrës. Kufizimi me bashkinë Lushnjë në veri, me Mallakastrën në jug, me Urën Vajgurore në lindje, me bashkinë Patos në jugperëndim, e bën atë një qendër urëkalimi të një zone me sipërfaqe 118.01 km². Kryeqendra e saj është qyteti i Roskovecit.

Pozita gjeografike e Roskovecit është e favorshme lidhur me pozicionimin e saj në afërsi të rrugëve kombëtare Tiranë – Vlorë, Fier – Berat, por edhe me mundësinë e lidhjes me zona të tjera si Kurjanin, Beratin e Tepelenën nëpërmjet rrugës Roskovec – Kurjan. Qyteti i Roskovecit ka një sipërfaqe prej rreth 1000 ha dhe zona urbane e saj përbën rreth 25.7% të kësaj sipërfaqeje.

Sipas ndarjes territorial, bashkia e Roskovecit përbëhet nga katër njësi administrative dhe administron qytetin dhe 14 fshatra:

- Roskovec (me fshatin Jagodinë)
- Kuman (me fshatrat Kuman, Marinëz, Vidhishtë, Luar)
- Kurjan (me fshatrat Kurjan, Mbërs, Ngjeqan, Vlosh)
- Strum (me fshatrat Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2, Velmish).

Territori i bashkisë së Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik.

Karakteristikat historike

Toponimi i stacionit Stephanafana që arkeologu austriak Kamilo Prashnikër sjell në lidhje me Roskovecin e ka burimin në kërkimet e tij për të gjetur degën jugore të rrugës Egnatia duke u nisur nga Apolonia.

Përveçse si stacion qëndrimi në shekullin XIX ekzistojnë mjaft dëshmi që tregojnë që Roskoveci shquhej edhe si vend i pazarit me të njëtin emër. Veprimtaria e Pazarit për mbi një shekull përcaktoi një rol thelbësor në rritjen e rëndësisë për vendndodhjen Frashër/Roskovec, e cila në vijim, në shekullin XX u kthye fillimisht në qendër administrative komune dhe disa dekada më vonë në qytet. Roskoveci në vitin 1922 rezultoi se kishte 25 shtëpi me 170 banorë. Në vitin 1923 ai u bë për herë të parë qendër administrative me statusin e krahinarisë dhe vula e administratës mbante emërtimin "Pazari i Frashërit".



BAZA LIGJORE

Bashkia Roskovec kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të përshpejtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

- a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritit me legjislacionin e Bashkimit Europian".

- b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave".

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban:

- a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;

ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;

iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;

iv. përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;

v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;

vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

b) këshillimin e projekt dokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në **Ligjin Nr. 107/2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, **VKM Nr. 686, datë 22.11.2017** “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, **Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së** “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar”, **Udhëzimi Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së** për një shtesë në Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Me Vendimin Nr.04 datë 10.06.2020 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec. Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me nevojën e bashkisë për:

- a. Mbështetje ndaj iniciativave për investime strategjike të cilat çojnë në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Projekt investimi në Infrastrukturë Energjitike, Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh dhe Zona Ekonomike.
- b. Përditësimin e njësive të reja që shtohen si arsye e projektit të infrastrukturës rrugore. Ndryshimet në njësitë ekzistuese në përshtatje me kërkesat e shqyrtuara.
- c. Përgjigjes së kërkesave të interesit të banorëve dhe të bizneseve në kuadrin e përmirësimit të shërbimeve në territorin e bashkisë si dhe investimeve strategjike.
- d. Përshtatjen e Planit të Përgjithshëm Vendor me kërkesat aktuale të zhvillimit si dhe fokusimin në zhvillimin ekonomik të zonës.

Stafi i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë bashkisë Roskovec ka analizuar me vemendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkisë për çështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim: përshtatjen e Planit të Përgjithshëm Vendor; reflektimin e kërkesave të ardhura në drejtim të Bashkisë Roskovec për nevojën të



komunitetit për zhvillim; si dhe rishikimin e disa kufijve të njësive strukturore në zonat që preken nga zhvillimi infrastrukturës rrugore i parashikuar për qytetin.

2. DOKUMENTET, PJESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidentuar që dokumentet që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV janë:

1. Plani i zhvillimit të territorit, ku përfshihen:

- plani i përdorimit të tokës;
- planin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike;
- hartat shoqëruese të planit;

2. Rregullorja e planit, ku jepen:

- kodifikimi;
- rregullat për çdo njësi, të cilat përfshijnë kushtet dhe koeficientët e zhvillimit për njësitë strukturore, objekt rishikimi;

Përmbajtja e dokumentit të rishikuar të PPV do të bazohet në VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përmbajë:

Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:

- a) ndryshimet e kufijve të njësive strukturore si rrjedhojë e propozimeve për ndryshim dhe përshtatje.*
- b) ndryshimet në pasaportat e njësive strukturore;*
- c) shtojcat përkatëse; në varësi të ndryshimeve*
- d) datamodel GIS me atributet përkatëse.*

Dokumentacioni i përgatitur në kuadër të procedurës së rishikimit të PPV këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Rregjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokumenti i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i Bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, përbëhet nga ekspertë të fushave:

- Të planifikimit të territorit;
- Të informacionit gjeohapësinor;
- Të mjedisit;
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës listohet si më poshtë:

1. Eneida Hoxha - *(Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit)*
2. Ariela Kushi - *(Ekspert Planifikimi)*
3. Vjollca Zeqo - *(Drejtoresh e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike)*
4. Eva Hatia - *(Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit)*
5. Gazment Zeneli - *(Ekspert Mjedisit)*
6. Eldison Kocaqi - *(Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pronave)*
7. Genci Myftari - *(Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë)*

Grupi i punës do të marrë në konsideratë kërkesat e ardhura në adresë të Bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-se, do të shqyrtojnë dhe do të propozojnë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisin relacionet përkatëse.

4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:

- a. Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
- b. Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.
- c. Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.

- d. Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.
- e. Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë Roskovec.

Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT


Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- b. Bashkia do të këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- c. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- d. Vendimi i Kryetarit për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- e. Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.

6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË


Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të Bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.



Konkretisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia nuk propozon të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor.

Drejtores e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Eneida Hoxha





Bashkia Roskovec
Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor

Raport Përmbledhës
i Kërkesave për Ndryshime

Draft 1.0

Datë 19.01.2024

Hartoi:

Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: *Eneida Hoxha*

Eksperti i Planifikimit: *Artela Kushi*

Eksperti Juristi: *Vjollca Zeqo*

Eksperti GIS: *Eneida Hoxha*

Eksperti i Mjedisit: *Gazmend Zeneli*

Përgjegjës i Sektorit të regjistrimit të pronave: *Eldison Kocaqi*

Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit: *Eva Hata*

Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë: *Genc Myftari*

Tabela e Përmbajtjes

KREU I NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË

KREU II NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT (PASAPORTAT)

KREU III NDRYSHIME NË HARTËN E RRJETIT RRUGOR E INFRASTRUKTUROR

SHTOJCA I

TABELA PËRMBLEDHËSE E NJËSIVE STRUKTURORE KU KËRKOHEN NDRYSHIME DHE E NJËSIVE TË REJA QË PROPOZOHEN TË SHTOHEN

SHTOJCA II

RAPORTI I EKSPERTIT TË MJEDISIT MBI SECILIN PREJ RASTEVE TË PROPOZUARA PËR RISHIKIM, KU DETAJOHET:

- 1. NËSE SECILI PREJ RASTEVE CËNON OSE JO VLERAT NATYRORE, MJEDISORE DHE ZONAT E MBROJTURA,**
- 2. NËSE SECILI PREJ RASTEVE DUHET T'I NËNSHTROHET OSE JO HARTIMIT TË VSM-SE**

KREU I
NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË

Në "Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec", nuk ka kërkesë për ndryshime.

KREU II

NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT (PASAPORTAT)

KËRKESA NR.1

Kodi i Njesisë Strukturore : RO_B_B2_19/8

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:


- a) *Sipërfaqja e njesisë nga "462.8 ha" ndryshon në "447.07 ha".*

Kodi i Njesisë së Re Strukturore: RO_IN_IEN1_19/1

Treguesit e zhvillimit për Njesisë e Re Strukturore:

- a) *Njësia: RO_IN_IEN1_19/1;*
b) *Zona: "RO_IN_IEN1_19";*
c) *Sipërfaqja (ha): "15.81 ha";*
d) *Nr. Banorësh: "-";*
e) *Dendësia: "-";*
f) *Sistemi: "IN.Infrastrukturë";*
g) *Kategoria_1: "IEN.Infrastrukturë Energjitike";*
h) *Nënkategori_1: "IEN1.Elektrike";*
i) *Përqindja e Përdorimit: "100%";*
j) *I: "LZH/LN";*
k) *KSHI (%): "Leje ZH/LN";*
l) *Lartësia në kate 1: "LZH/LN";*
m) *Lartësi në metra 1: "LZH/LN";*
n) *Parcela_Minimale_1: "LZH/LN";*
o) *Përdorime_të_Lejuara: "LZH/LN";*
p) *Përdorime_të_ndaluar: "Banim";*
q) *Përdorime_të_kushtëzuara: "-";*
r) *KSHR (%): "LZH/LN";*
s) *KSHP (%): "LZH/LN";*
t) *Gjelbërim_Banor: "-";*
u) *Vendparkime: "LZH/LN";*
v) *Mënyra_e_ndërhyrjes: "LZH/LN";*
w) *Tipologjia_Hapësinore: "LZH/LN";*
x) *PDV: "JO";*
y) *Fazat_e_Zhvillimit: "-";*
z) *Kufizime_Ligjore: "Zhvillimi në këtë njësi duket të ketë në konsideratë legjislacionin për: mbrojtjen e tokës bujqësore, vaditjen dhe kullimin, mbrojtjen e mjedisit dhe çdo sektor që preket nga operimi i strukturave për prodhimin e energjisë në këtë njësi";*
aa) *Kushte_të_tjera: "-";*
bb) *Instrumenti: "-";*
cc) *Funksion_1: "IEN1-2.Termocentral elektrik"*

Kodi i Njësive Strukturore kufitare: Njesisë kufitare nuk preken nga ndryshimet.



Argumentimi i Kërkesës:

Kërkesa për ndryshim vjen si nevojë për të mbështetur iniciativat lokale, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Një zhvillim i tillë jo vetëm që do të ofronte alternativa për zgjidhjen e krizës ndaj kërkesës në rritje për energji, por gjithashtu do të siguronte një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm me energji elektrike. Duke iu referuar "pikës 2 të Nenit 26 të Ligjit Nr.107/2014" planet mund të ndryshohen (rishikohen) kur ka ndryshime apo nevoja të shkaktuara nga kriza sektoriale. Ky zhvillim që propozohet do të ndikojë pozitivisht në uljen ndaj varësisë të importit të energjisë elektrike në vend, duke u afruar me objektivin strategjik të qeverisë për t'a shndërruar Shqipërinë nga një vend importues në një vend eksportues neto të energjisë elektrike brenda vitit 2030.

Gjithashtu kjo kërkesë kërkon të harmonizohet me Dokumente e Projekte Madhore ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në mbështetje të Ligjit Nr.43 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe VKM Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar jep miratimin për Vazhdim Procedure dhe Miratimin Paraprak Nr. 1427/2 Prot., datë 05.04.2023 "Për ndërtimin e termocentralit me kapacitet të instaluar 170 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Rostovec, Qarku Fier".

Aktualisht zona ku propozohet ky projekt ndodhet në Kategorinë B.Tokë Bujqësore e cila nuk lejon zhvillime të reja. Është e rëndësishme se sipërfaqja e propozuar është mundësia e vetme për realizimin e Termocentralit për shkak të afërsisë strategjike me nyjen e lidhjes me TAP.

Kërkohet krijimi i një njësie të re strukturore me kategori kryesore IEN.Infrastrukturë Energjitike që do të plotësojë kushtet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij projekti strategjik.

Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015:

Bashkia Roskovec kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian".

b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave"

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
- c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Ndryshimi në tabelën e treguesve të zhvillimit, si në parametra ashtu dhe në funksione, është bazuar në Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015.

Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi:

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar Shqipëria 2030 propozohet vlerësimi i mundësive nga sektorët përkatës për ripërdorim të termocentraleve ekzistues apo të rinj, që përdorin energjinë nga gazi është një nga pikat për polin e zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat

Gjithashtu kjo kërkesë është në përputhje me Vendimin Nr.822 datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni".

Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve:

Bashkia vlerëson se ky ndryshim duhet të trajtohet me procedurë të thjeshtuar pasi plotëson kriteret e përcaktuara sipas VKM Nr.686/2017, e ndryshuar dhe nuk çënon Vlerat Natyrore e Mjedisore, Zonat e Mbrojtura, Trashëgiminë Historike e Kulturore, nuk ndryshon Strategjine Territoriale.

KËRKESA NR.2

Kodi i Njesisë Strukturore : RO_UB_IE2_75/3

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:


a) Sipërfaqja e njesisë nga "449.36ha" ndryshon në "440.12ha".

Kodi i Njesisë së Re Strukturore: RO_IN_IMB2_20/1

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:

- a) Njësia: RO_IN_IMB2_20/1;
- b) Zona: "RO_IN_IMB_20";
- c) Sipërfaqja (ha): "9.24 ha";
- d) Nr. Banorësh: "-";
- e) Dendësia: "-";
- f) Sistemi: "IN.Infrastrukturë";
- g) Kategoria_1: "IMB.Infrastrukturë Menaxhim Mbetjesh";
- h) Nënkategori_1: "IMB2.Depozitim Mbetjesh";
- i) Përqindja e Përdorimit: "100%";
- j) I: "LZH/LN";
- k) KSHT (%): "Leje ZH/LN";
- l) Lartësia në kate 1: "LZH/LN";
- m) Lartësi në metra 1: "LZH/LN";
- n) Parcela_Minimale_1: "LZH/LN";
- o) Përdorime_të_Lejuara: "Neni 45";
- p) Përdorime_të_ndaluara: "Neni 45";
- q) Përdorime_të_kushtëzuara: "Neni 45";
- r) KSHR (%): "LZH/LN";
- s) KSHP (%): "LZH/LN";
- t) Vendparkime: "LZH/LN";
- u) Mënyra_e_ndërhyrjes: "LZH/LN";
- v) Tipologjia_Hapësinore: "-";
- w) PDV: "JO";
- x) Fazat_e_Zhvillimit: "-";
- y) Kufizime_Ligjore: "Vendim KKT nr.28, date 10.05.2013 "Për miratimin e Planit të Integruar Sektorial për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, vendimi Patos Marinëz, Qarku Fier"";
- z) Kushte_të_tjera: "-"
- aa) Instrumenti: "-"
- bb) Funksion_1: "-"

Kodi i Njesisë Strukturore kufitare: Njesitë kufitare nuk preken nga ndryshimet.



Argumentimi i Kërkesës:

Sipas Vendimit Nr. 575, datë 24.6.2015 të Këshillit të Ministrave, Njësitë e qeverisjes vendore, në planet e përgjithshme vendore, duhet të parashikojnë vende për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe lëndësive për mbetje inerte. Bazuar në këtë vendim, PPV e Bashkisë Roskovec ka propozuar që vend-depozitimi i përkohshëm i mbetjeve inerte të jetë në nivel rajonal duke përfshirë bashkinë Roskovec dhe Patos, konkretisht në fshatin Kuqar të bashkisë së Patosit.

Duke u bazuar në propozimet e planit të përgjithshëm vendor, bashkia Roskovec ka marrë nismën në janar 2022 për realizimin e këtij projekti. Nga korrespondencat e vazhdueshme me bashkinë Patos ka rezultuar që zona e përcaktuar në PPV Patos, përdoret nga kompani private për aktivitetin shfrytëzim karriere. Nga ky moment nuk ka pasur vazhdimësi nisma e marrë.

Duke u ballafaquar nga situata aktuale si dhe duke u referuar ligjit në fuqi, Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", si dhe VKM Nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"; është detyrim dhe kompetencë e bashkisë; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, në bashkinë Roskovec lind nevoja urgjente për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve inerte në mënyrë minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Për të përcaktuar zonën e Kompostimit dhe grumbullimit të inerteve, është marrë në konsideratë, largësia nga zonat e banuara, largësia nga lumi, statusi i pronësisë si dhe lloji i tokës. Prona e vendit në dispozicion të ndërtimit të vendgrumbullimit është prënjësi e Komunës Kuman (sot Njësia Administrative Kuman).

Aktualisht zona ku propozohet ky projekt ndodhet në Kategorinë IE.Industri Ekonomi dhe IEN. Infrastrukturë Energjitike.

Kërkohet krijimi i një njësie të re strukturore me kategori kryesore IMB.Infrastrukturë Menaxhim Mbetjesh që do të plotësojë kushtet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij projekti strategjik.

Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015:

Bashkia Roskovec kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686. date 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian".

b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave"

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;

b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;

c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Ndryshimi në tabelën e treguesve të zhvillimit, si në parametra ashtu dhe në funksione, është bazuar në Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015.

Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi:

Kërkesa e Bashkisë është në përputhje me VKM nr. 575, datë 24.6.2015" Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" dhe legjislacionet sektoriale në fuqi.

Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve :

Bashkia vlerëson se ky ndryshim duhet të trajtohet me procedurë të thjeshtuar pasi plotëson kriteret e përcaktuara sipas VKM Nr.686/2017, e ndryshuar dhe nuk çënon Vlerat Natyrore e Mjedisore, Zonat e Mbrojtura, Trashëgiminë Historike e Kulturore, nuk ndryshon Strategjinë Territoriale.

KËRKESA NR.3

A. Rasti 1

Kodi i Njësive Strukturore : RO_UB_S1_77/4

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen: Për njësitë RO_UB_S1_77/4; kërkohet shtimi i kategorise IE.Industri Ekonomi, (pa ndryshuar sistemet aktuale).

- a) Kategori 2, nga "A-Banım" ndryshon në "IE.Industri dhe Ekonomi";
- b) Nënkategori 2, nga "A1-Banım" ndryshon në "IE3.Aktivitet Ekonomik Kompleks";
- c) Përqindja e përdorimit 1, nga "80%" ndryshon në "50%";
- d) Përqindja e përdorimit 2, nga "20%" ndryshon në "50%";
- e) I_2, nga "1" ndryshon në "1.8";
- f) KSHT_2, nga "45%" ndryshon në "60%";
- g) Lartësia_kate_2, nga "2K" ndryshon në "3K";
- h) Lartësia_metra_2, nga "0" ndryshon në "Sipas projektit";
- i) Parcela_minimale_2, nga "300m2" ndryshon në "1.000m2";
- j) PDV, nga "JO" ndryshon në "PO";
- a) Kushte të tjera, nga "Lartësia në metra sipas Nenit 20; 3 kate me tarracë ose çati të pashfrytëzuar; Nevojë për hartimin e një plani rrugore paraprak." ndryshon në "Lartësia në metra sipas Nenit 20; tarracë ose çati e pashfrytëzuar; Në rastin e banesave ekzistuese në njësitë strukturore me përdorim të propozuar IE apo IE+S, përdorimi "banım" parashikohet si i përkohshëm, ndaj edhe për këto njësi kërkohet hartimi i dokumentit të PDV-së, përmes të cilit: a) duhet të garantohen kushtet për hapësira në funksion të banimit; b) një bashkëjetesë mes këtyre funksioneve të ndryshme; c) do të vlerësohet strategjia për zhvendosjen e funksionit banım"; Në këtë njësi lejohen dhe funksionet e kategorisë IE1.Industri e Lehtë (si fabrika, magazine etj.)

Kodi i Njësive të Re Strukturore: Nuk krijohet njësi e re strukturore

Kodi i Njësive Strukturore kufitare: Njesitë kufitare nuk preken nga ndryshimet.

B. Rasti 2

Kodi i Njësive Strukturore : RO_UB_S2_77/3;

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen: Për njësitë; RO_UB_S2_77/3; kërkohet shtimi i kategorise IE.Industri Ekonomi, (pa ndryshuar sistemet aktuale).

- a) Kategori 2, nga "A-Banım" ndryshon në "IE.Industri dhe Ekonomi";
- b) Nënkategori 2, nga "A1-Banım" ndryshon në "IE3.Aktivitet Ekonomik Kompleks";
- c) Përqindja e përdorimit 1, nga "80%" ndryshon në "50%";
- d) Përqindja e përdorimit 2, nga "20%" ndryshon në "50%";
- e) I_2, nga "1" ndryshon në "1.8";
- f) KSHT_2, nga "45%" ndryshon në "60%";
- g) Lartësia_kate_2, nga "2K" ndryshon në "3K";
- h) Lartësia_metra_2, nga "0" ndryshon në "Sipas projektit";
- i) Parcela_minimale_2, nga "300m2" ndryshon në "1.000m2";
- j) PDV, nga "JO" ndryshon në "PO";

- b) Kushte të tjera, nga "Lartësia në metra sipas Nenit 20; 3 kate me tarracë ose çati të pashfrytëzuar; Nevojë për hartimin e një plani rrugore paraprak." ndryshon në "Lartësia në metra sipas Nenit 20; tarracë ose çati e pashfrytëzuar; Në rastin e banesave ekzistuese në njësitë strukturore me përdorim të propozuar IE apo IE+S, përdorimi "banim" parashikohet si i përkohshëm, ndaj edhe për këto njësi kërkohet hartimi i dokumentit të PDV-së, përmes të cilit: a) duhet të garantohen kushtet për hapësira në funksion të banimit; b) një bashkëjetesë mes këtyre funksioneve të ndryshme; c) do të vlerësohet strategjia për zhvendosjen e funksionit banim"; Në këtë njësi lejohen dhe funksionet e kategorisë IEI.Industri e Lehtë (si fabrika, magazine etj.)

Kodi i Njesisë së Re Strukturore: Nuk krijohet njësi e re strukturore

Kodi i Njësive Strukturore kufitare: Njesitë kufitare nuk preken nga ndryshimet.

A. Rasti 3

Kodi i Njësive Strukturore : RO_UB_S2_33/1;

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen: Për njësinë; RO_UB_S2_33/1 kërkohet shtimi i kategorise IE.Industri Ekonomi, (pa ndryshuar sistemet aktuale).

- c) Kategori 2, nga "-" ndryshon në "IE.Industri dhe Ekonomi";
- d) Nënkategori 2, nga "-" ndryshon në "IE3.Aktivitet Ekonomik Kompleks";
- e) Përqindja e përdorimit 1, nga "100%" ndryshon në "50%";
- f) Përqindja e përdorimit 2, nga "-" ndryshon në "50%";
- g) I_2, nga "-" ndryshon në "1.8";
- h) KSHT_2, nga "-" ndryshon në "60%";
- i) Lartësia_kate_2, nga "-" ndryshon në "3K";
- j) Lartësia_metra_2, nga "-" ndryshon në "Sipas projektit";
- k) Parcela_minimale_2, nga "-" ndryshon në "1.000m²";
- l) Kushte të tjera, nga "Lartësia në metra sipas Nenit 20; 3 kate me tarracë ose çati të pashfrytëzuar; Nevojë për hartimin e një plani rrugore paraprak." ndryshon në "Lartësia në metra sipas Nenit 20; tarracë ose çati e pashfrytëzuar; Në rastin e banesave ekzistuese në njësitë strukturore me përdorim të propozuar IE apo IE+S, përdorimi "banim" parashikohet si i përkohshëm, ndaj edhe për këto njësi kërkohet hartimi i dokumentit të PDV-së, përmes të cilit: a) duhet të garantohen kushtet për hapësira në funksion të banimit; b) një bashkëjetesë mes këtyre funksioneve të ndryshme; c) do të vlerësohet strategjia për zhvendosjen e funksionit banim"; Në këtë njësi lejohen dhe funksionet e kategorisë IEI.Industri e Lehtë (si fabrika, magazine etj.)

Kodi i Njesisë së Re Strukturore: Nuk krijohet njësi e re strukturore

Kodi i Njësive Strukturore kufitare: Njesitë kufitare nuk preken nga ndryshimet.

Argumentimi i Kërkesës:

Si arsye e ndryshimeve me ritme të shpejta demografike, sociale dhe ekonomike Bashkia Roskovec është gjithnjë e më shumë e fokusuar drejt mundësive të ndryshme për thithjen e investimeve. Bashkia synon të ofrojë një mjedis tërheqës për investitorët vendas dhe të huaj, me qëllim zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës.

Bashkia Roskovec ka lidhur një marrëveshje me Shoqatën për Autonomi Vendore për ta kthyer qytetin miqësor ndaj investimeve të huaja (business friendly). Bashkelidhur gjeni marrëveshjen dhe listim të kriterëve të BFC SEE.

Kjo marrëveshje ka synim promovimin e bashkisë ndaj investitorëve të huaj. Një nga kushtet e këtij bashkëpunimi është ofrimi dhe lehtësimi i procedurave të investimit duke nisur nga përcaktimi i zonave ekonomike-industriale dhe lehtësimi i dhënies së lejes së ndërtimit. Për këtë arsye, lind nevoja për disa ndryshime në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Roskovec.

Për të përcaktuar zonën më të përshtatshme për krijimin e këtyre poleve ekonomike-industriale, jemi bazuar në: pozicionin në lidhje me qendrat e banuara, aksesueshmërinë dhe shtrirjen përgjatë aksit SH73. Janë përcaktuar territore ku PPV ka patur të parashikuar zhvillime me shërbime tregtare dhe ndryshimi synon që në këto territore të akomodohen dhe shërbime industriale komplekse si nënkategorit IE3-Aktivitet Ekonomik Kompleks.

Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015 :

Bashkia Roskovec kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, date 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Pr Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislaclonin e Bashkimit Europian".

b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave"

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
- c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Ndryshimi në tabelën e treguesve të zhvillimit, si në parametra ashtu dhe në funksione, është bazuar në Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015.

Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi:

Kërkesa nuk cënon legjislacionin në fuqi.

Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve:

Bashkia vlerëson se ky ndryshim duhet të trajtohet me procedurë të thjeshtuar pasi plotëson kriteret e përcaktuara sipas VKM Nr.686/2017, e ndryshuar dhe nuk cënon Vlerat Natyrore e Mjedisore, Zonat e Mbrojtura, Trashëgiminë Historike e Kulturore, nuk ndryshon Strategjinë Territoriale.

KËRKESA NR.4

Kodi i Njësive Strukturore : RO_IN_INT1_8/1;

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen: Për njësitë RO_IN_INT1_8/1 kërkohet ndryshimi i pozicionit të Terminalit,


a) Sipërfaqja e njësisë nga "0.77ha" ndryshon në "0.54ha".

Kodi i Njësive së Re Strukturore: Nuk krijohet njësi të re strukturore

A. Kodi i Njësive Strukturore kufitare: RO_UB_S2_70/64;

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:


a) Sipërfaqja e njësisë nga "1.43ha" ndryshon në "2.2ha".



B. Kodi i Njësive Strukturore kufitare: RO_UB_A2_70/57;

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:

a) Sipërfaqja e njësisë nga "6.05ha" ndryshon në "2.2ha".



Argumentimi i Kërkesës:

Kërkesa për ndryshim vjen si nevojë për të plotësuar nevojat e qytetarëve me shërbimet kryesore. Ndërtimi i terminalit vjen si prioritet i bashkisë për investim. Bashkia ka realizuar një studim ku kërkesa për të transferuar në një pikë tjetër terminalin bëhet për çështje efikasiteti dhe akses më të lehtë duke pasur parasysh dhe ndryshimet në qarkullimin e qendrës së qytetit. Vendndodhja e re kërkon t'i japë një shtysë të re zhvillimit të kësaj zone dhe krijohet një lidhje më e mirë me akset që janë në projekt nga Bashkia Roskovec.

Në vendodhjen aktuale (ku kërkohet shkrirja e njësisë ekzistuese të Terminalit dhe përfshirja e saj në njësinë kufitare) Bashkia synon ta transformojë në një zonë me karakter shërbime si një Pol në qytet të dedikuar ndaj këtij sektori. Njësia e Terminalit i bashkangjitet njësisë kufitare e cila ka kategorinë S2. Shërbime Tragtare dhe Biznesi.

Aktualisht zona ku propozohet ky projekt ndodhet në Kategorinë A2. Banim dhe Shërbime.

Kërkohet krijimi i një njësie të re strukturore me kategori kryesore INT. Infrastruktura Transporti që do të plotësojë kushtet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij projekti strategjik.

Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015:

Bashkia Roskovec kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Pr Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Europian".

b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedure të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave"

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;

c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Ndryshimi në tabelën e treguesve të zhvillimit, si në parametra ashtu dhe në funksione, është bazuar në Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015.

Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi:

Kërkesa nuk çënon legjislacionin në fuqi.

Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve:

Bashkia vlerëson se ky ndryshim duhet të trajtohet me procedurë të thjeshtuar pasi plotëson kriteret e përcaktuara sipas VKM Nr.686/2017, e ndryshuar dhe nuk çënon Vlerat Natyrore e Mjedisore, Zonat e Mbrojtura, Trashëgiminë Historike e Kulturore, nuk ndryshon Strategjinë Territoriale.

KËRKESA NR.5

Kodi i Njësive Strukturore : RO_UB_A1_70/35

Treguesit e Zhvillimit që kërkohen të ndryshohen:

- a) Kategori 2, nga "-" ndryshon në "S.Shërbime";
- b) Nënkategori 2, nga "-" ndryshon në "S2.Shërbime Tregtare dhe Biznesi";
- c) Përqindja e përdorimit 1, nga "100%" ndryshon në "80%";
- d) Përqindja e përdorimit 2, nga "-" ndryshon në "20%";
- e) I_2, nga "-" ndryshon në "1.5";
- f) KSHT_2, nga "-" ndryshon në "50%";
- g) Lartësia_kate_2, nga "-" ndryshon në "3K";
- h) Lartësia_metra_2, nga "-" ndryshon në "Neni 40";
- i) Funksion_2, nga "-" ndryshon në "S2.4.Treg Shumice";

Kodi i Njësive të Re Strukturore: Nuk krijohet njësi e re strukturore

Kodi i Njësive Strukturore kufitare: Njesitë kufitare nuk preken nga ndryshimet.

Argumentimi i Kërkesës:

Kërkesa përndryshim vjen si nevojë për të plotësuar nevojat e qytetarëve me shërbimet kryesore. Ndërtimi i Tregut Agro-Ushqimor vjen si prioritet i bashkisë për investim. Bashkia ka realizuar një studim ku ka përcaktuar zonën e Tregut Agro-Ushqimor në këtë pikë, duke pasur parasysh aksesin dhe ndryshimet në qarkullimin e qendrës së qytetit. Vendndodhja e re kërkon t'i japë një shtysë të re zhvillimit të kësaj zone dhe krijohet një lidhje më e mirë me akset që janë në projekt nga Bashkia Roskovec.

Aktualisht zona ku propozohet ky projekt ndodhet në Kategorinë A1.Banim.

Kërkohet të shtohet kategoria e dytë e përdorimit të tokës S.Shërbime, pjesë e të njëjtës njësi strukturore.

Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015 (plotësohet për secilin rast):

